



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2023-10

**Prokurori kundër Sabit Januzit dhe Ismet Bahtjarit**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 27 tetor 2023

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Dytë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrime**

---

**Prokurores së Specializuar**  
Kimbërli P. Uest

**Mbrojtësit Kujdestar të Sabit Januzit**  
Tomas Gillis

**Mbrojtësit Kujdestar të Ismet Bahtjarit**  
Hendrik Sitema

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në bazë të nenit 39(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 96(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) lëshon këtë urdhër.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 12 tetor 2023, pas paraqitjes së parë të Sabit Januzit dhe Ismet Bahtjarit (“z. Januzi”, “z. Bahtjari” së bashku, “të akuzuarit”) më 9 tetor 2023,<sup>2</sup> u zhvillua konferenca e parë mbi ecurinë e çështjes (“konferenca e parë mbi ecurinë e çështjes”).<sup>3</sup>

2. Më 24 tetor 2023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi vendimin kornizë: (i) mbi nxjerrjen e provave dhe çështje lidhur me të; si dhe (ii) për trajtimin e informacionit konfidencial gjatë hetimeve dhe kontakteve ndërmjet një pale ose pjesëmarrësi dhe dëshmitarëve të palës kundërshtare ose të një pjesëmarrësi (“Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave”).<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2023-10, F00001, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 11 shtator 2023, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2023-10, [Transcript of Hearing](#) (Transkripti i seancës), 9 tetor 2023, publik, f. 1-16; [Transcript of Hearing](#) (Transkripti i seancës), 9 tetor 2023, publik, f. 17-32. *Shih gjithashtu* F00017, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Decision Setting the Date for the Initial Appearances of Sabit Januzi and Ismet Bahtjari and Related Matters* (Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë të Sabit Januzit dhe Ismet Bahtjarit dhe Çështje të Lidhura me Të), 6 tetor 2023, publik, para. 21(a)-(b).

<sup>3</sup> KSC-BC-2023-10, [Transcript of Hearing](#) (Transkripti i seancës), 12 tetor 2023 (“Transkripti i Konferencës së Parë mbi Ecurinë e Çështjes”), publik, f. 33-71.

<sup>4</sup> KSC-BC-2023-10, F00076, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To*, 24 tetor 2023, konfidencial, me Shtojcën 1, publike. Versioni i redaktuar publik i vendimit u dorëzua po atë ditë, [F00076/RED](#).

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

### A. KONFERENCA MBI ECURINË E ÇËSHTJES

3. Në bazë të rregullës 96(1) të Rregullores, në vijim të konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes pas paraqitjes fillestare të të akuzuarit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thërret konferenca pasuese mbi ecurinë e çështjes, nëse del e nevojshme, ndër të tjera, për: (i) organizimin e shkëmbimeve midis palëve dhe, kur është e zbatueshme, me mbrojtësin e viktimave, për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykim; (ii) ndërmarrjen e hapave që mundësojnë çdo përgatitje të nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë; dhe (iii) rishikimin e ecurisë së çështjes gjyqësore dhe që palëve t'u jepet mundësia e ngritjes së problemeve në lidhje me këtë çështje gjyqësore.

4. Në bazë të rregullës 96(2) të Rregullores, me pëlqimin me shkrim të të akuzuarit që jepet pas këshillimit me Mbrojtësin, konferenca për ecurinë e çështjes mund të mbahet: (i) në praninë e të akuzuarit dhe me pjesëmarrjen e Mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës; (ii) në praninë e Mbrojtësit dhe me pjesëmarrjen e të akuzuarit nëpërmjet videokonferencës; ose (iii) në mungesë të të akuzuarit me praninë e Mbrojtësit, ose pjesëmarrjen e Mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës. Gjithashtu, çdo kërkesë për pjesëmarrje në konferencën mbi ecurinë e çështjes nëpërmjet videokonferencës i drejtohet drejtpërdrejt Administratores, në përputhje me Udhëzuesin e Punës së Zyrës Administrative për Videolidhjet (KSC-BD-23/COR), paraprakisht në kohë të mjaftueshme, në mënyrë që Administratorja të ndërmarrë hapat e duhur, përfshirë informimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.<sup>5</sup>

---

<sup>5</sup> Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, F00062, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Decision Authorising Video Link Participation](#) (Vendim për Autorizim të Pjesëmarrjes përmes Videolidhjes), 6 nëntor 2020, publik, para. 10; F00069, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Decision Authorising Video Link Participation](#) (Vendim për Autorizim të Pjesëmarrjes përmes Videolidhjes), 9 nëntor 2020, publik, para. 9.

## B. NXJERRJA E PROVAVE

5. Në bazë të nenit 21(6) të Ligjit, i gjithë materiali dhe provat ose faktet relevante në zotërim të Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS") të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit, i vihen në dispozicion të akuzuarit para fillimit të procesit dhe gjatë procesit, vetëm me kufizimet rreptësisht të domosdoshme dhe me zbatimin e masave mbrojtëse kompensuese të nevojshme. Në bazë të rregullës 102(3) të Rregullores, ZPS-ja i jep njoftim të hollësishëm Mbrojtjes për çdo material dhe provë që ka në zotërim.

6. Në bazë të rregullës 109(b) dhe (c) të Rregullores, si ZPS-ja dhe Mbrojtja, nëse vendosin për nxjerrjen e materialeve, kur i nxjerrin materialet: (i) japin një përshkrim të qartë dhe të përmbledhur të dokumenteve, ose të kategorive të dokumenteve, që i janë dhënë palës kundërshtare; dhe (ii) e kategorizojnë informacionin në përputhje me akuzat në aktakuzën e konfirmuar, duke iu referuar veprave penale konkrete që përbëjnë bazën e tyre, elementet kontekstuale të veprave penale, veprimet e pretenduara të të akuzuarit, ose, kur është e zbatueshme, provat që do të paraqiten nga ZPS-ja.

## C. REDAKTIMET

7. Në bazë të nenit 23(1) të Ligjit dhe rregullës 80(1) të Rregullores, trupi gjykues mund të urdhërojë masa të përshtatshme për mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore dhe të personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmimeve të dëshmitarëve.

8. Në bazë të rregullës 80(4)(a)(i)-(iii), (d) dhe (e) të Rregullores, ndër këto masa mund të përshihen fshirja e emrave dhe të dhënave identifikuese të një personi për të parandaluar, nëse është e domosdoshme, nxjerrjen për të akuzuarin dhe/ose publikun, të identitetit dhe/ose vendndodhjes së një dëshmitari, viktime pjesëmarrëse në

procesin gjyqësor, ose të një personi të lidhur familjarisht apo në ndonjë mënyrë tjetër me ta.

9. Në bazë të rregullës 108(1) të Rregullores, ZPS-ja mund t'i bëjë kërkesë konfidenciale dhe *ex parte* Trupit Gjyqësor për mosnxjerrje të informacionit në tërësi ose pjesërisht, kur nxjerrja e këtij informacioni mund të dëmtojë, ndër të tjera, hetimet aktuale ose të ardhshme. Në përputhje me rregullën 108(6) të Rregullores, e njëjta gjë vlen *mutatis mutandis* për Mbrojtjen.

#### D. DOSJET PARAPRAKE

10. Në bazë të rregullës 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në që brenda një afati të përcaktuar, të paraqesë: (i) dosjen e vet paraprake, ku të përfshijë çfarëdo pranimi në lidhje me faktet nga ana e Mbrojtjes, si dhe një listë të pikave të pakontestuar; (ii) listën e dëshmitarëve që synon t'i thërrasë të dëshmojnë në gjykim; dhe (iii) listën e provave materiale që synon të paraqesë gjatë gjykimit, ku përfshihet, kurdo që është e mundshme, çfarëdo kundërshtimi i Mbrojtjes lidhur me autenticitetin e tyre.

11. Në bazë të rregullës 95(5) të Rregullores, pas dorëzimit të materialeve të përmendura në rregullën 95(4) të Rregullores nga ZPS-ja, Gjykatësi i Procedurës Paraprake fton Mbrojtjen që, brenda një afati të përcaktuar, të dorëzojë dosjen e vet paraprake. Gjithashtu, brenda afatit të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Mbrojtja njofton ZPS-në mbi synimin e vet për të përdorur alibinë ose çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësinë penale, ndër të cilat aftësia mendore e kufizuar, intoksikimi, domosdoshmëria, shtrëngimi dhe gabimet faktike apo ligjore.

## III. DISKUTIM

12. Gjykatësi i Procedurës Paraprake cakton mbajtjen e konferencës së dytë mbi ecurinë e çështjes **të premtën, 3 nëntor 2023, në orën 09:30.**

13. Gjykatësi i Procedurës Paraprake do t'u kërkojë palëve të japin informacion të përditësuar, nëse ka, lidhur me aspektet ende të pazgjidhura nga rendi i ditës së konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes,<sup>6</sup> si dhe parashtrimet e tyre me shkrim dhe me gojë në lidhje me to.<sup>7</sup> Konkretisht dhe përveç sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të kërkojë përditësime lidhur me sa vijon:

- a) nëse palët kanë hasur ndonjë vështirësi në lidhje me nxjerrjen e materialit provues;
- b) nëse palët kanë hasur ndonjë problem në lidhje me përkthimin e materialit provues;
- c) nëse ZPS-ja ka bërë përparim të konsiderueshëm me hetimet që i kanë mbetur për të kryer, ose kur do t'i përfundojë ZPS-ja hetimet e veta;
- d) kur do të jetë në gjendje ZPS-ja të dorëzojë dosjen paraprake dhe materialin në lidhje me të në përputhje me rregullën 95(4)(a)-(c) të Rregullores, në bazë të kalendarit për nxjerrjen e materialit të përcaktuar në Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave; dhe

---

<sup>6</sup> KSC-BC-2023-10, F00022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Order Setting the Date for the First Status Conference and for Submissions](#), Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Parë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrime), 9 tetor 2023, publik, me Shtojcën 1, publike.

<sup>7</sup> KSC-BC-2023-10, F00025, Mbrojtja e z. Bahtjari, *Parashtrime lidhur me Rendin e Ditës të Konferencës mbi Ecurinë e Çështjes*, 10 tetor 2023, publike; F00026, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë për Konferencën e Parë mbi Ecurinë e Çështjes*, 11 tetor 2023, publike; F00027, Mbrojtja e z. Januzi, *Parashtrime lidhur me Rendin e Ditës të Konferencës mbi Ecurinë e Çështjes*, 11 tetor 2023, konfidenciale; [First Status Conference Transcript](#) (Transkripti i Konferencës së Parë mbi Ecurinë e Çështjes)

- e) bazuar në informacionet e përditësuara të dhëna nda ZPS-ja në lidhje me problemet e mëparshme dhe procesin në vijimësi të nxjerrjes së materialeve (që është planifikuar të vazhdojë deri në fillim të vitit 2024), nëse Mbrojtja është në gjendje – ose se kur pret të jetë në gjendje - të japë më shumë informacion për: (i) ecurinë e hetimeve të saj; (ii) synimin për të dhënë njoftim për alibi ose arsye që përjashtojnë përgjegjësinë sipas rregullës 95(5) të Rregullores dhe për nxjerrje të provave sipas rregullës 104(1) dhe (2) të Rregullores; dhe (iii) synimin për të bërë kërkesa lidhur me mundësinë hetimore unike sipas rregullës 99(1) të Rregullores.

14. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se të dyja palët do të japin informacion të përditësuar mbi diskutimet *inter partes* në lidhje me nënkategorizimin që do të zbatohet në këtë çështje gjyqësore në sistemin elektronik *Legal Workflow*.<sup>8</sup>

15. Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në, Mbrojtjen e z. Januzi dhe Mbrojtjen e z. Bahtjari të dorëzojnë parashtrime me shkrim për aspektet e lartpërmendura, përfshirë temat e diskutuara gjatë konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, ndonjë aspekt tjetër që nuk është përfshirë në rendin e ditës së konferencës së dytë mbi ecurinë e çështjes, apo ndonjë vështirësi në lidhje me nxjerrjen e materialit provues, jo më vonë se të martën, 31 tetor 2023, në orën 16:00 (ZPS), dhe të mërkurën, 1 nëntor 2023, në orën 16:00 (ekipet e Mbrojtjes së të akuzuarve).

---

<sup>8</sup> [Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave), para. 87-89.

